



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19 NËNTOR 2025, ora 11.00**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE XX. NOVEMBRA 2025. GODINE, 11.00 časova**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2025**

Rendi i ditës

1. Formimi i komisioneve parlamentare,
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 09/L-002 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën në kuadër të instrumentit për reforma dhe rritje,
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 09/L-003 për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit për Programin e parë për “Financimin e Politikave Zhvillimore për Efektivitetin Fiskal, Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Gjellbër” ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (pjesë e Grupit të Bankës Botërore),
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 09/L-004 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për “Instrumentin për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor” ndërmjet Bashkimit Evropian, që përfaqësohet nga Komisioni Evropian si Huadhënës, dhe Republikës së Kosovës si Huamarrës, dhe Bankës Qendrore të Kosovës si Agjent i Huamarrësit,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 09/L-005 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin “Kompas“-Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës Për Forcimin E Sistemit Të Shëndetësisë,
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 09/L-006 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZH) për Projektin “Edukimi në fëmijërinë e hershme dhe kujdesi për kapitalin njerëzor të Kosovës”,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 09/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026,
8. Miratimi i buxhetit për komunat: Prishtinë, Gjilan dhe Zubin Potok,
9. Çështja e financimit të RTK-së.

Dnevni red

1. Formiranje parlamentarnih komisija,
2. Razmatranje Nacrt-zakona br. 09/L-002 o ratifikaciji sporazuma između Republike Kosovo i Evropske Unije o aranžiranjima za implementaciju podrške Unije Kosovu u okviru instrumenta za reforme i rast,
3. Razmatranje Nacrt-zakona br. 09/L-003 o ratifikaciji Sporazuma o finansiranju za prvi program “Finansiranje razvojnih politika za fiskalnu efikasnost, konkurentnost i zeleni rast”, između Republike Kosovo koju predstavlja Ministarstvo finansija, rada i transfera i Međunarodnog udruženja za razvoj (deo Grupe Svetske banke),
4. Razmatranje Nacrt-zakona br. 09/L-004 o ratifikaciji Sporazuma o Zajmu za “Instrument za Reforme i Rast za Zapadni Balkan” između Evropske unije, koju predstavlja Evropska Komisija kao zajmodavac, i Republike Kosovo kao zajmoprimca, i Centralne Banke Kosova kao Agenta zajmoprimca,
5. Razmatranje Nacrt-zakona br. 09/L-005 o ratifikaciji Sporazuma o Kreditu između Republike Kosovo koju predstavlja Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera, i Međunarodne Asocijacije za Projekat “Kompas” - sveobuhvatan pristup Kosova jačanju zdravstvenog sistema,
6. Razmatranje Nacrt-zakona br. 09/L-006 o ratifikaciji Sporazuma o Kreditu između Republike Kosovo koju predstavlja Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera i Međunarodne Asocijacije za Projekat “Kompas” - sveobuhvatan pristup Kosova jačanju zdravstvenog sistema,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 09/L-001 o budžetskim izdvajanjima za budžet Republike Kosovo za 2026. godinu,
8. Usvajanje budžeta za opštine: Priština, Gnjilane i Zubin Potok,
9. Pitanje finansiranja RTK.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Dimal Basha.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Të nderuara media,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të thirrur me kërkesën e 42 deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Pika e parë e rendit të ditës është:

1. Formimi i komisioneve parlamentare

Të nderuar deputetë,

Sipas nenit 19, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, përcaktohet se Kryesia e Kuvendit në fillim të legjislaturës, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare propozon për miratim në seancë plenare numrin, strukturën dhe fushëveprimin e komisioneve parlamentare. Në rastin tonë jemi në rrethana të jashtëzakonshme, kemi Kuvend të konstituuar, por ende nuk kemi komisione funksionale.

Duhet theksuar se fillimisht pritja jonë ka qenë votimi i Qeverisë dhe më pas vazhdimi i punës në Kryesi për themelimin e këtyre komisioneve. Por, në mosvotimin e Qeverisë dhe kohën e gjatë që mori konstituimi i Kuvendit jemi përballur me një situatë jo të zakonshme, në të cilën vendi ynë është vënë para disa sfidave që kam menduar se mund t'i tejkalojmë si Kuvend, por gjithmonë me mirëkuptimin e të gjitha grupeve parlamentare.

Bëhet fjalë për disa çështje urgjente që Kuvendi ka mandatin t'i trajtojë, e ato janë: pesë marrëveshje ndërkombëtare me vlerë deri në 1 miliard euro, buxhetin e vitit 2026 prej rreth 4 miliardë euro, buxhetet e tri komunave që po përballen me vështirësi të theksuara financiare, si dhe çështja urgjente e pagave të punëtorëve të RTK-së, të cilët ende nuk i kanë marrë pagat e muajit tetor.

Më 30 tetor kam mbajtur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit, ku kam kërkuar nga nënkryetarët dhe shefat e grupeve parlamentare që të ecin përpara me formimin e komisioneve parlamentare, në mënyrë që t'i tejkalojmë këto çështje jetike, meqë Kuvendi tanimë është funksional, pra i konstituuar. Fatkeqësisht, këtë mirëkuptim nuk e kam gjetur te një pjesë e grupeve parlamentare dhe Kuvendi ka mbetur pa trajtuar asnjë nga çështjet e mësipërme.

Të dashur kolegë,

Duke marrë parasysh që sot kemi votimin e Qeverisë dhe se të gjitha subjektet politike janë deklaruar se nuk do ta votojnë mandatarin e dytë, atëherë për mua ka qenë e arsyeshme që ta

mbështes thirrjen edhe të një seance të jashtëzakonshme, si mundësi të fundit për t'i trajtuar nga ky Kuvend këto çështje kaq me rëndësi për qytetarët. Me mirëkuptimin e të gjithë deputetëve të Kuvendit, sot ende e kemi këtë mundësi dhe unë jam i gatshëm që sa më parë të thërras një mbledhje të Kryesisë dhe bashkë me përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike të procedojmë së paku me themelimin e katër komisioneve të përhershme, ku në këtë mënyrë do të mundësojë votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, buxhetit vjetor, buxhetit të tri komunave, si dhe miratimi i raportit të RK-së, me çka do të mundësonte ekzekutimin e mjeteve për funksionimin e transmetuesit publik dhe pagat e punëtorëve.

Çështjet e kësaj seance, të nderuar kolegë deputetë, nuk kanë të bëjnë me veprime politike, prandaj edhe një herë bëj thirrje për të gjitha subjektet politike që t'i analizojnë me maturi në kontekst të rrethanave shtetërore që gjendemi, dhe pritjet e qytetarëve tanë, të cilët nuk e meritojnë që ta pamundësojmë votimin e këtyre ligjeve jetike për shkak të inateve të paarsyeshme politike.

Unë këtu e përfundoj dhe i ftoj deputetët e interesuar për deklarime përkitazi me këtë çështje dhe e hap diskutimin.

Nga Lëvizja Vetëvendosje, shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zonja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar nënkryetarë,

Të dashur kolegë deputetë nga Legjislatura IX, ju që jeni këtu në sallë dhe ju të tjerët që po e përcillni këtë seancë nga jashtë sallës së Kuvendit, përkundrejt se do duhej të ishit këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Shumë të dashur qytetarë të Republikës,

Të respektuara media që jeni këtu në sallë.

Siç e hapi këtë seancë edhe kryetari i Kuvendit, radha dhe rendi do të duhej të ishte që Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratonte agjendën e kësaj seance. Rrethanat në të cilat gjendet vendi, janë rrethana të cilat kanë paparashikueshmëri në raport me një pjesë të fondeve të dedikuara për Republikën.

Ajo çka për ne është shumë e rëndësishme sot, është të marrim përgjegjësinë për detyrën e deputetit që e kemi, ta ushtrojmë atë përgjegjësi me nder, por gjithashtu edhe me obligimin që qytetarët e këtij vendi na e kanë dhënë.

Më e lehta është që të abstenohet ose të mos vihet fare, siç kanë bërë, fatkeqësisht, përfaqësuesit e grupeve të tjera parlamentare, ata që nuk janë sot këtu, nga Partia Demokratike e Kosovës, nga

Lidhja Demokratike e Kosovës, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nga Nisma Social-Demokrate dhe një grup tjetër parlamentar.

Megjithatë, ajo nuk e arsyeton ose nuk u heq përgjegjësinë që e kanë dhe mund ta kenë në formimin e komisioneve të përhershme parlamentare. Agjenda e ditës së sotme, përjashtoi buxhetin për vitin 2016, që është buxhet i propozuar nga qeveria, e cila sipas Ligjit për buxhetin dhe Ligjin për Qeverinë nuk e përjashton mundësinë që ta prezantojë Qeveria në detyrë, të gjitha pikat e tjera janë pika të detyrës dhe përgjegjësi të deputetëve të Kuvendit të Republikës. Formimi i komisioneve parlamentare nuk bëhet me propozimin e Qeverisë, formimi i komisioneve të përhershme parlamentare bëhet në mes të grupeve parlamentare, rrjedhimisht mbledhen drejtuesit e grupeve parlamentare, bëjnë propozimin me radhë sipas forcës politike të fituar në Kuvend dhe konstituohen komisionet parlamentare.

Për të vazhduar me mbarëvajtjen dhe pikat e agjendës së kësaj seance janë formimi i katër komisioneve të përhershme parlamentare, të cilat, për opinionin publik po e sqaroj, përcaktohen me radhë: e para zgjedh Lëvizja Vetëvendosje, e dyta Partia Demokratike, e treta Lidhja Demokratike dhe kështu me radhë. Kështu konstituohet deri në numrin final të komisioneve të përhershme parlamentare. Pas formimit të komisioneve parlamentare, vijnë me radhë shqyrtimi i pikave të rendit të ditës. Kush jemi ne në këtë periudhë të vitit t'u mohojmë të drejtën qytetarëve të Republikës për fonde të drejtpërdrejta buxhetore, të cilat humben në muajin dhjetor.

Plani i Rritjes, pika e radhës pas formimit të komisioneve parlamentare nga Bashkimi Evropian ka afat skadence, në të cilin në dhjetor të vitit 2025 nëse nuk miratohet, 10% nga 880 milionë euro humbin, janë pa kthim, nuk mund të kthehen edhe nëse zgjedhjet mbahen më 21 dhjetor, më 28 dhjetor apo kurdo që caktohen. Edhe nëse zgjedhjet mbahen në pranverë, këto mjete humbin. Humb mundësia e investimit të drejtpërdrejtë në politika zhvillimore, në agjendën e gjelbër, në Planin e Rritjes së vendit tonë. Kush jemi ne t'u mohojmë të drejtën e 20 milionë eurove të tjera të mbështetjes buxhetore, gjegjësisht me marrëveshjet nga Banka Botërore.

200 milionë euro është vlera e mbështetjes buxhetore, 100 milionë nga një projekt tjetër i Bankës Botërore skadencën e ka në mars të vitit 2026. Ne, të nderuar deputetë, të dashur qytetarë të Republikës, po ballafaqohemi me kërkesa çdo ditë, nga punëtorët e Radiotelevizionit të Kosovës, të vetmit transmetues publik në Republikën tonë, të cilët përkundrejt se ne deputetët kemi marrë pagat e muajit tetor, nuk kanë paga të muajit tetor, e ata deputetë që nuk ulen sot këtu në sallë për të votuar raportin e Radiotelevizionit të Kosovës, le ta mendojnë edhe një herë përgjegjësinë e tyre ndaj 700 familjeve të punëtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës. E vetmja mundësi për disbursim të mjeteve Radiotelevizionit të Kosovës është miratimi i raportit në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe kjo bëhet përmes Komisionit të përhershëm për buxhet dhe financa.

Dhe, prapë nuk janë këtu, dhe prapë kjo seancë duhet të vazhdojë deri në momentin kur ata binden për të qenë këtu dhe për të votuar. Tri komuna në Republikën e Kosovës janë pa buxhet të miratuar për vitin 2025: kryeqyteti, për arsye se nuk kanë arritur që brenda afateve të përcaktuara me ligj të miratojnë buxhetin e vet dhe të përcjellin te Ministria e Financave dhe te Kuvendi i Kosovës, ku bashkë me buxhetin e vitit 2025, në nëntor të vitit 2024 nuk ka qenë pjesë edhe buxheti i Prishtinës, i miratuar në asamblenë komunale.

Nuk ka kapërcim të procedurës, nuk ka, çdo kapërcim tjetër, çdo nënshkrim tjetër i buxhetit të Komunës së Prishtinës, Gjilanit dhe Zubin Potokut do të ishte shkelje. Vetëm ky Kuvend me mandatarë 120 deputetë të Republikës së Kosovës ka të drejtë të votojë buxhetin dhe rrjedhimisht të disbursohen mjetet për këto tri komuna dhe të tri komunat të kenë mundësinë pastaj të kryejnë pagesat për kontraktorët, operatorët dhe natyrisht për shërbimet që i kanë për qytetarët. Secili diskutim tjetër, qoftë që bëhet me trajtime përmes prokurorisë, gjykatës, Gjykatës Kushtetuese nga Komuna e Prishtinës është farsë.

Unë shpresoj që ata e dinë, por nëse nuk e dinë, edhe më keq se janë këtu edhe për katër vjet të tjera dhe nuk janë të gatshëm të bëjnë zgjidhje për qytetarët e kryeqytetit dhe për tërë Kosovën që derivon këtu në Prishtinë. Dhe, përgjegjësinë për këtë duhet ta kishte edhe partia, e cila u shpall fituese në kryeqytet.

Të dashur deputetë të Kuvendit,

Të nderuar qytetarë,

Të gjithë ju që po na përcillni,

Nuk është kjo që kemi dëshiruar, nuk është ajo çfarë kemi synuar, por është e mundshme. Deputetët e Kuvendit të Republikës janë me mandat të plotë, Kuvendi është shpallur i konstituar, dy herë të tjera kur janë bërë ndalesa për punën e Kuvendit, herën e parë kur synohej që po bëhej shkelje me komisionin për votim të fshehtë u ftua dhe Gjykata Kushtetuese dhe u bë aktor politik këtu me ne bashkë, u stërzgjat procesi. Në vend që të ushtrohej detyra e deputetëve të partive të deritashme opozitare, të votonin kundër komisionit dhe të vazhdonim tutje të procedonim.

Prapë herën e dytë ndodhi me nënkryetarin e Kuvendit nga komuniteti serb. Prapë u ftua Gjykata Kushtetuese të bëhet aktor politik, dhe u bë, prapë u vonuam dhe prapë ja ku jemi, me Kuvend të konstituar. Mandatin tonë nuk mund t'ia japim edhe t'ia delegojmë gjykatës, mandatin tonë duhet ta ushtrojmë vetë, vota jonë ka vlerë, ka peshë, mund të bëjë ndryshimin sot, mund të konstitujë komisionet e përhershme, mund të votojë marrëveshjet ndërkombëtare e gjithashtu mund të zhblllokojë tri komunat e Republikës së Kosovës dhe të miratojë buxhetin për Radiotelevizionin e Kosovës. Ne kemi mundësi ta bëjmë këtë ndryshim.

Prandaj, nga kjo foltore sot i ftoj të gjitha grupet parlamentare, të cilat nuk janë prezentë, të vijnë, t'i thërrasin ndërgjegjes për përgjegjësinë që e kanë. Nuk e kemi për betejë politike,

marrëveshjet nuk janë për një Qeveri, as nuk janë për një parti, janë për të gjithë qytetarët pa dallim, andaj mos t'u mohojmë këtë të drejtë. Nuk janë fonde që mund të kthehen, janë fonde që humben.

Ne betejën politike do ta bëjmë në fushatë zgjedhore, por të mos u kushtojë shumë më shtrenjtë qytetarëve të Republikës, se pa ato miratime humben fondet, por do të humbet edhe një pjesë e ndërgjegjes suaj që e keni për obligim politik e qytetar të miratojmë e të procedojmë tutje.

I falënderoj të gjithë deputetët që janë në sallë dhe, edhe një herë u bëj thirrje të gjithë deputetëve që sot kanë zgjedhur bojkotin, në vend të pjesëmarrjes, që të mendojnë mirë, të kthehen, të procedojmë me agjendën e ftuar të Kuvendit të Republikës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të PDK-së, e ka kërkuar fjalën deputeti Përparim Gruda.

PËRPARIM GRUDA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë kam ardhur sot këtu në këtë sallë për të përfaqësuar mendimin e Partisë Demokratike të Kosovës dhe për të shpjeguar qëndrimin pse ne nuk marrim pjesë në këtë seancë dhe pse për ne kjo seancë është jokushtetuese.

E para, nuk e di, kryetar, nëse ka kuorum, nëse janë 61 deputetë në këtë sallë, mund ta verifikoni ju, kjo seancë do të mbahet mend në historinë e Kosovës si seanca në të cilën të gjithë ne: kryetari i Kuvendit, deputetët e Vetëvendosjes, qytetarët e Kosovës, çdo kush në këtë shoqëri e di që është e paligjshme dhe jokushtetuese. Asnjë vend nuk mund të mbajë seancë, një Kuvend nuk mund të mbajë seancë pa zgjedhur qeverinë.

Mos u ngut se një jam, kështu që sot duroni pak të flas edhe unë, se një jam prej PDK-së.

KRYETARI: Kolegë deputetë, qetësi, ju lutem!

PËRPARIM GRUDA: A mund të krijoni kushte që të mbaj fjalimin?

Ju nuk ma diktoni qysh e mbaj unë fjalimin, unë e mbaj fjalimin që dua unë, ma lejon Rregullorja.

KRYETARI: Zoti Gruda, vazhdo me fjalimin, për shkak se nuk dëgjohet...

PËRPARIM GRUDA: S'mund të mbaj në këto kushte kur të gjithë flasin përnjëherësh. Asnjë Kuvend, më lejoni ta shpjegoj ligjërisht, asnjë Kuvend, pra nuk kam ardhur të bëj propagandë politike, kam ardhur ta shpjegoj ligjërisht.

Në asnjë vend nuk lejohet që një qeveri, një Kuvend të mblidhet dhe të trajtojë çështje të tjera përveç zgjedhjes së Qeverisë. Midis konstituimit të Kuvendit dhe zgjedhjes së Qeverisë nuk lejohet të mbahet asnjë seancë e ndërmjetme për asnjë çështje. Kjo është praktika e derisotme parlamentare e Kosovës dhe është një standard i njohur në mbarë botën, nuk ndodh asnjëherë.

Tani po i kthehem çështjes së rendit të ditës, i cili është propozuar, rendi i ditës i propozuar sot është: Formimi i komisioneve parlamentare dhe miratimi i disa projektligjeve. E para, për të treguar që kjo seancë ka logjikë, si mund të formohen komisionet parlamentare kur nuk është definuar kush është pozita e kush opozita në këtë vend. Se komisionet themelohen mbi bazën që njëra parti merr një anëtar komisioni sipas opozitës, njëra sipas faktit që është në pozitë.

S'ka Kosova opozitë dhe pozitë sot, s'mund të formohen komisione parlamentare. E dyta, miratimi i projektligjeve: Qeveria jonë është qeveri në detyrë, jo qeveri në dorëheqje. Unë e kam këtu me vete Ligjin për Qeverinë, neni 31 thotë që Qeveria në dorëheqje "nuk mund të paraqesë në Kuvend projektligje" dhe, po ashtu ky ligj thotë që këto kufizime, paragrafi 5 i nenit 31 thotë "vlejnë edhe për qeverinë në detyrë", këtë qeveri që e kemi ne.

Pra, nuk mund të procedojë ligje në Kuvend, i vetmi përjashtim bëhet për Qeverinë në dorëheqje, për të cilën thotë se ka të drejtë të propozojë Ligjin për buxhetin në Kuvend. Kjo nuk është qeveri në dorëheqje, kjo është qeveri në detyrë. Përjashtimi vlen, zoti Murati, vetëm për qeverinë në dorëheqje, jo qeverinë në detyrë. Unë do ta lexoj, meqenëse ka nevojë ta lexojë, thotë: "Përjashtimisht, pra nga ajo e mospropozimit të ligjeve, qeveria në dorëheqje ka të drejtë t'i propozojë Kuvendit miratimin e buxhetit të Republikës së Kosovës", kaq e thjeshtë. Qeveria në dorëheqje. Pse? A doni ta lexoj paragrafin 5? Mirë! Ish-ministrja e Drejtësisë që e kërkon.

Kufizimet e përcaktuara në këtë nen vlejnë edhe për Qeverinë, siç është përcaktuar në nenin 28 për Qeverinë.

Aty flitet për Qeverinë në detyrë, të mos i përziejmë. Shiko! Unë jam i bindur që ti nuk e di çka është Qeveria në dorëheqje e çka është në detyrë.

Mos më ndërhyj!

Mos abuzo me detyrën! Mos abuzo me detyrën! Ti je nënkryetare e Kuvendit, unë jam deputet. Unë po mbaj fjalën.

S'e kam me ty debatin, e kam me qytetarët e Kosovës.

Prandaj, ju s'keni të drejtë të propozoni ligj. Dhe, ka një arsye pse. Qe po e shpjegoj pse është kjo kështu. Sepse, kur Qeveria është në dorëheqje, Kuvendi që e ka zgjedhur atë Qeveri vazhdon të ekzistojë dhe ka lidhje legjitimiteti midis Qeverisë në dorëheqje dhe Kuvendit aktual.

Të nderuar kolegë,

Ky Kuvend nuk ka asnjë lidhje me Qeverinë ekzistuese. Kuvendi që e ka zgjedhur Qeverinë, nuk ekziston. Ai Kuvend i takon historisë. Nuk mund të vini këtu.

Qytetarë të nderuar që na shikoni,

Për ta ilustruar këtë, çka nënkupton kjo?! Kjo nënkupton që kryeministri Kurti, të cilin unë e kam përballë në rreshtin dhe ministrin e Financave, po do të dalë këtu, ta propozojë Ligjin për buxhetin dhe të shkojë pesë hapa tutje dhe të ulët e të votojë si deputet për këtë ligj. Nuk mund të ndodhë kjo. Nuk mund të ndodhë. Është absurde!

E ndalon ligji, po e ndalon edhe logjika. Nuk mund të vishë këtu, zoti Kurti, ta propozoni ligjin, zoti Murati, edhe të uleni në rreshtin e parë të Kuvendit dhe të votoni. Nuk mundesh. Thjesht nuk mundesh.

Dhe, argumenti i fundit. Për juve, zoti Murati, Gjykata Supreme, e që vlen për krejt Qeverinë, ka nxjerrë vendim. Ka thënë nuk keni të drejtë të qëndroni ministër. Ju po i mbani në mënyrë jokushtetuese funksionin e ministrave, kryeministrit dhe deputetëve. S'mund të mbani funksione të dyfishta. S'mundeni, thjesht. Ky ligj dhe Kushtetuta që është në fuqi e ndalon këtë. Nuk mund të luajmë ne një teatër të absurdit, ku ju bëheni herë ministra, herë kryeministra, herë deputetë. S'mund t'i luani të gjitha funksionet.

Fakti që e keni thirrur një seancë në orën 11 që t'i miratoni këto ligje, tregon që në orën 12:00 jeni dorëzuar për Glauk Konjufcën. Se po të bëhej kryeministër Glauk Konjufca në orën 11:00, në orën 14 do të ishte seancë kushtetuese. Jeni dorëzuar! Pra, s'mund të zgjidhet! Dhe, unë po ju them diçka: Ju do të hyni në historinë e Kosovës si partia e vetme që i dështojnë dy kandidatët për kryeministër.

Në këtë Kuvend, s'ka njeri tjetër që ka marrë mandat prej shefit të shtetit të Kosovës, prej Presidentes, Presidentit, edhe ka ardhur e ka dështuar. Do të bëheni partia e dytë. Unë nuk mendoj që ata që ju kanë votuar, kanë pritur të silleni kështu.

Edhe unë kërkoj, unë kërkoj si deputet i këtij Kuvendi, jam betuar ta mbroj Kushtetutën dhe ligjin, në emër të atij betimi, të ndërpritet, kryetar, kjo seancë dhe të mblidhemi në seancën e orës 14:00, se kjo është një seancë komplet jokushtetuese.

Ajo për çka kam ardhur unë sot është sepse nëse deri sot kam besuar që ndonjëherë s'e keni ditur, ndonjëherë e keni bërë për motive të caktuara, sot të gjithë e dini që kjo seancë është jokushtetuese. Të gjithë! Edhe çdo qytetar që na shikon e di, se çdokush e lexon këtë tekst. Çdokush! Edhe nënkryetarja e Kuvendit që reagon, edhe ministri i Financave që reagon, e dinë.

Po ju po doni të tregoni sikur jeni të interesuar t'i mbronin qytetarët e Kosovës. Dhe kjo seancë është fushatë elektorale për zgjedhjet. Po, do të ketë zgjedhje të reja! Mos e përdorni Kuvendin të bëni fushatë! Ky vend s'është për fushatë.

Qytetarët e Kosovës duhet ta dinë që nëse do të kishte vullnet prej kësaj Qeverie, do të gjendej zgjidhja për nëntë muaj, e nuk do të lihej ditën e fundit.

Nuk është se e keni hall interesin e qytetarëve të Kosovës. Nuk e keni hall. Kështu, kjo sjellje përveç jokushtetuese, është sjellje jopolitike. Sjellja politike do të nënkuptonte ta njihni rezultatin e zgjedhjeve. Ju nuk e keni fituar shumicën. Nuk e keni fituar shumicën për ta bërë vetë Qeverinë. Nuk e keni fituar. Ky është realiteti.

Sa më parë që e njihni këtë realitet, më mirë për juve, më mirë për Kosovën, më mirë për të gjithë neve.

Kështu që, për fund, për ta mbyllur. Do të mbahet mend ky Kuvend për dy gjëra. Siç thashë, për dy dështimet e kandidatëve për kryeministër, edhe për këtë seancë që është komplet jokushtetuese, që e dini edhe ju.

Shpresoj që zgjedhjet e reja të prodhojnë një shumicë tjetër, një shumicë, e cila në rend të parë e respekton Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Duhet ndërtuar një shumicë që ka forcë ta bëjë Qeverinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Po, faleminderit!

Veç shkurt, për z. Gruda.

Zoti Gruda, në legjislaturën e kaluar s'ke qenë deputet. Sa për njohurinë tuaj, më 29 shkurt 2024, AAK ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme pa kuorum. Më 16. 10. 2024 PDK gjithashtu ka mbajtur një seancë të jashtëzakonshme, ku s'ka pasur kuorum. Pra, është një praktikë, dhe kjo është mundësuar nga kryetari, pararendësi im, z. Glauk Konjufca.

E dyta, unë e kuptoj që mbase edhe mund ta kesh si argument çështjen e themelimit të komisioneve, kush është pozitë apo opozitë. Po unë e kam diskutuar edhe në mbledhje të Kryesisë. Për besë, ne mund t'i bëjmë pesë-pesë. Pesë prej nesh, pesë bëni ju. I bëjmë veç dhjetë deputetë nëpër secilin komision dhe e tejkalojmë krizën. S'do të duhej të ishte kjo çështje. Ne

s'po duam të fitojmë aty, të dukemi si pozitë apo opozitë, sa e kemi me interes t'i tejkalojmë këto çështje.

Çështjet tuaja janë procedurale dhe unë i respektoj qëndrimet tua, por mendoj që është më e rëndësishme këto çështjet që i kemi thirrur, e që janë marrëveshjet ndërkombëtare, buxheti vjetor, buxhetet komunale dhe pagat e shtatëqind familjeve të RTK-së. Veç desha për sqarim të çështjet e seancës së jashtëzakonshme.

Për replikë e kemi deputetin Murati.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara media,

Të nderuar qytetarë,

Në raport me fjalimin që sapo e mbajti deputeti Gruda, u thanë disa të pavërteta. U tha që nuk lejohet të mbahet seancë pa u votuar Qeveria, megjithëse Kuvendi është i konstituuar. Mirëpo, më lejoni t'ia rikujtoj z. Gruda, sepse e di fort mirë që kjo nuk qëndron, sepse nuk është e shkruar askund një gjë e tillë. Pra, askund nuk është e shkruar. Ai iu referua praktikave, por praktikat bëhen duke e zbatuar në praktikë. Kjo është një praktikë që po formohet tash. Pra, kemi një situatë të jashtëzakonshme dhe mund të shfrytëzohet si e tillë.

Për faktin që deputeti Gruda është sot këtu, edhe pas konferencës për media nga Vlora Çitaku, që e pamë pak më herët, tregon edhe për disonancën brenda vetë partisë. Pra, me gjasë, e kanë vlerësuar që nuk ka bërë një punë të mirë në konferencë dhe tash është dashur të vijë deputeti Gruda këtu me sqarime shtesë, e që po e shoh që është në siklet, sepse si jurist po i nevojitet të thotë të pavërteta, me gjëra që edhe ai vetë e di që nuk pajtohet.

U tha që komisionet nuk mund të formohen, sepse ende nuk dihet kush është pozitë e kush opozitë. E pavërtetë, gjithashtu. Kjo vlen vetëm për dy komisione. Është Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së, të cilin duhet ta udhëheqë opozita, dhe është Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të cilin gjithashtu duhet ta udhëheqë opozita.

Por, të gjitha komisionet e tjera nuk varen kush është pozitë e kush opozitë. Ato përcaktohen, zgjidhen, kryesimi i tyre zgjidhet varësisht nga madhësia e grupit parlamentar. Grupi parlamentar më i madh zgjedh i pari, pastaj i dyti e kështu me radhë. Ndërkaq, përbërja e vetë komisioneve reflekton fuqinë politike të grupeve parlamentare dhe s'ka të bëjë fare a është pozitë apo opozitë. E, aq më pak për katër komisionet e përhershme, të cilat duhet të funksionojnë pati apo s'pati Qeveri fuqiplotë. Sepse, janë komisione, të cilat i mbikëqyrin edhe institucionet e tjera vitale që s'kanë të bëjnë fare me ekzekutivin. Pra, e kemi gjyqësorin, i kemi institucionet e tjera të pavarura, Avokatin e Popullit, ndërmarrjet publike...

KRYETARI: Regjia, edhe një minutë, ju lutem!

HEKURAN MURATI: Pra, të gjitha këto institucione s'kanë të bëjnë fare me Qeverinë. Pra, a po i bie që, përderisa s'ka Qeveri, s'duhet Kuvendi t'i mbikëqyrë këto institucione? Pra, kjo e demanton edhe një herë qëndrimin e pasaktë të z. Gruda.

U fol edhe për nenin 31, paragrafi 5. Më lejoni t'ia rikujtoj z. Gruda, siç e kam bërë edhe pak më herët në Facebook, që paragrafi 5 nuk thotë kufizimet në paragrafin 1 të këtij neni, por thotë kufizimet në këtë nen. Pra, që nënkupton edhe paragrafin 2, edhe paragrafin 3, edhe paragrafin 4. Pra, nuk vlen ajo që po thotë z. Gruda, po keqinterpreton qëllimshëm.

Po, për më tepër, nëse paska qenë problem buxheti i vitit 2026, se qenka miratuar prej Qeverisë, pse atëherë nuk po i formojnë komisionet? Cili është kundërshtimi që po refuzojnë ta miratojnë edhe buxhetin për Komunën e Prishtinës, atë të Gjilanit e Zubin Potokut? Ato nuk janë buxhete që i ka bërë Qeveria. Janë buxhete që i kanë bërë kuvendet komunale përkatëse. Qeveria vetëm i ka proceduar këtu. Nuk janë buxhete të Qeverisë. Pra janë buxhete të komunave.

KRYETARI: Kundërreplikë, z. Gruda, një minutë!

PËRPARIM GRUDA: Shkurt, kryetar!

Nuk e kam ndërmend ta zgjas shumë. Po dua ta them vetëm një fakt. Fakti që Vetëvendosje ka zgjedhur që çështjet juridike t'i mbrojë përmes ministrit të Financave, tregon mjaftueshëm sa seriozisht e keni marrë Kushtetutën dhe ligjin.

Unë nuk mendoj as që e keni bërë punën si ekonomist mirë, po nejtë.

Edhe një herë, po e sqaroj për të fundit herë. Nuk e kuptoj pse e bën atë lexim, pse s'je jurist! Ky nen, paragrafi 5. Prit! Tash ta lexoj unë. Prit pak, prit pak!

Kufizimet e përcaktuara në këtë nen vlejnë edhe për Qeverinë. Në këtë nen. Kufizimet, o zotëri, kufizimet!

Ndërkaq, neni që të lejon ta sjellësh këtu, thotë: përjashtimisht. A e kupton përjashtimin prej kufizimit? Paragrafi thotë: përjashtimet.

Mund të qeshni sa të doni, njerëzit janë duke na parë.

KRYETARI: Regjia, veç pak. Z. Gruda, edhe tridhjetë sekonda. Dua të bëj përjashtim.

PËRPARIM GRUDA: Kufizimi nënkupton pamundësinë për ta sjellë ligjin. Përjashtimi thotë: “Ligjin mund ta sjellë Qeveria që është në dorëheqje”. Këto janë shumë të qarta, unë s’mendoj që kam debat më shumë me juve.

Fakti, edhe një herë po them, që keni zgjedhur të mbroheni me një ekonomist për çështje juridike, tregon shumë. Më vjen keq! Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Replikë ka kërkuar znj. Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kam vetëm një replikë të shkurtër me z. Gruda.

Së pari, nuk është në rregull që nuk e lexon nenin deri në fund, paragrafin deri në fund. Pra, paragrafin 5 të nenit 31, sepse ky thotë kështu: “Kufizimet e përcaktuara në këtë nen vlejnë edhe për Qeverinë në situatën siç përcaktohet në nenin 28, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i këtij ligji, deri në zgjedhjen e Qeverisë së re”.

Pra, mandati i Qeverisë përfundon, pika, paragrafi 1.1, me përfundimin e mandatit katërvjeçar të Kuvendit. Pra, ne e kemi përfunduar mandatin katërvjeçar në fund të marsit.

Prandaj, edhe ligji na lejon, pra kjo Qeveri në detyrë të dërgojë buxhet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Dhe, në këto rrethana, mendoj që është jashtëzakonisht e rëndësishme që opozita, LDK e PDK, AAK e Nisma, e Lista serbe, sepse jeni bërë bashkë gjatë gjithë kësaj kohe, jeni bashkë edhe sot për të bojkotuar vendime tepër të rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Buxheti nuk është i Albin Kurtit. Nëse keni inat me kryeministrin Kurti, po jua bëj të qartë: buxheti prej rreth katër miliardë eurosh është i shtetit, është i qytetarëve.

Dhe, mendoj që po të kishte prokurori të përgjegjshme e profesionale, të gjithë ata të cilët tentojnë ta fusin vendin në krizë sociale, do të duhej të përgjigjeshin penalisht.

Ne, po, kemi mundur ta bëjmë Qeverinë, por ne nuk bëjmë pazare siç keni bërë ju. Me tenderë, me ambasada, me Listën serbe që jemi detyruar t’i presim me orë të tëra këtu në Kuvend vetëm për t’ua dhënë votën për Qeverinë. Ne s’jemi si ju, prandaj ne s’bëjmë ashtu. Shkojmë në zgjedhje dhe pastaj qytetarët e Republikës së Kosovës japin ndëshkimin që ju e meritoni.

KRYETARI: Kundër-replikë, z. Gruda!

PËRPARIM GRUDA: Po ta ketë një vend ministre të Drejtësisë për pesë vjet, një person që s'i dallon kufizimet prej përjashtimeve në ligj, është e tmerrshme.

Edhe një herë, kufizimet thotë vlejné, kufizimet. Në qoftë se e gjeni një jurist të pavarur në këtë vend që e thotë këtë që po e thotë ish-ministrja e Drejtësisë, unë e dorëzoj mandatin e deputetit. Në qoftë se ka gjykatë, po jua jap një premtim publik. Jo, prit, prit, prit! Një premtim publik! Në qoftë se e çoni ju në cilëndo gjykatë të Kosovës dhe del siç po thoni ju, unë premtim publik, e dorëzoj mandatin. Mbajeni mend prej meje! Unë e dorëzoj mandatin. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Prej Grupit multietnik, znj. Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljuem se uvaženi Predsedniče Parlamenta Republike Kosova!

Dame i gospodo,

Uvaženi poslanici i predstavnici diplomatskih misija,

Uvaženi medija,

Mi kao multietnička parlamentarna grupa, koja je sastavljena od različitih poslanika koji dolaze iz redova različitih zajednica ovde na Kosovu, bošnjačke, turske, srpske, aškalijske, egipćanske, romske zajednice, odgovorno i svesno, stojimo ovde u nadi da ćemo danas izglasati ratifikaciju međunarodnih sporazuma, izglasati budžet naše države, koji je porastao više od četiri milijarde.

Ja sam neko ko je u petom-šestom sazivu i znamo kada smo glasali budžet naše države dok je bio i milijardu eura, i glasali ga pod jako težim uslovima nego danas. Tako da, svi smo mi odgovorni da oslobodimo put, da kreiramo parlamentarne komisije, da glasamo budžet Republike Kosova, koji se odnosi pre svega na ratifikaciju međunarodnih sporazuma koji direktno utiču na ekonomski razvoj naše države, na pomoć u zdravstvenom sistemu i pomoć u obrazovnom sistemu naših građana.

Trebamo svesno i odgovorno pristupiti rešavanju ovog problema i otvoriti put ka kreiranju nove vlade, a mi kao grupa glasaćemo i za našeg kandidata, gospodina Glauka Konjufcu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, znj. Rexhepi!

Atëherë s'ka të tjerë nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Sipas radhës, fjalën e ka z. Kurti.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës, z.Dimal Basha!

E nderuar nënkryetare e Kuvendit të Republikës, znj. Albulena Haxhiu,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të dalë nga legjislatura e nëntë, pas zgjedhjeve të 9 shkurtit.

Të nderuar gazetarë dhe punonjës të tjerë të mediave,

Të dashur qytetarë,

Një arsye logjike pse komisionet duhet të ngrihen si trupa të Kuvendit, specifikisht ato të përhershme, e që janë katër: buxheti, legjislacioni, integrimi evropian dhe komunitetet joshumicë, vjen nga vetë emri i tyre, nga nominalja e tyre.

Pra, ky lloj komisioni ka rol të vijueshëm, të qëndrueshëm, që ruhet e nuk ndërron. Prandaj edhe quhen të përhershme; komisione të përhershme të Kuvendit të Republikës.

Në njëfarë mënyre, shteti i pavarur si Republikë demokratike po na thotë: Pavarësisht dinamikave që mund të jenë, katër komisione parlamentare i kam kyçe që të ekzistojnë dhe të punojnë.

Pra, janë të përhershme pikërisht për situatat e zakonshme e jo të zakonshme; janë a s'janë qeveritë në detyrë, në dorëheqje, e fuqiplotë.

Ato janë komisione funksionale, në funksion të ministrive që potencialisht mund të krijohen prej një qeverie që legjislativi e voton. Ato, prandaj edhe quhen komisione funksionale të Kuvendit të Republikës. Por, katër sosh janë të përhershme. Janë në shtetin tonë të rrënjosura edhe më thellë se vetë Qeveria.

Rrjedhimisht, në këso raste, veprojmë në trupat që janë esenciale, e gjendja tani është esenciale për Republikën tonë.

E, tash kur po i diskutojmë temat esenciale për vijimësinë e punëve të shtetit, temat përkojnë pikërisht me fushëveprimtarinë e këtyre komisioneve që janë të përhershme:

Buxheti për vitin 2026, buxheti për Radiotelevizionin e Kosovës, buxheti 2025 për Komunitet e Prishtinës, Gjilanit e Zubin Potokut, Plani i Rritjes së Bashkimit Evropian dhe marrëveshjet ndërkombëtare me Bankën Botërore.

I nderuar kryetar Basha,

Të nderuar deputetë,

Le të fillojmë me Planin e Rritjes së Bashkimit Evropian. Sot po vendosim për miratim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën, në kuadër të instrumentit për reforma dhe rritje, e njohur si Marrëveshja për Instrumentin për Reforma apo Plani i Rritjes; si dhe Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për kredinë në kuadër të këtij instrumenti.

Nga Instrumenti për Reforma dhe Rritje parashihet të përfitojmë 882,6 milionë euro, nga të cilat afro 30 për qind, apo 253,3 milionë euro, janë grante, ndërkah pjesa tjetër, 629,3 milionë euro janë kredi.

Qëllimi i marrëveshjes kornizë, teksti i së cilës është standard për të gjitha shtetet përfituese, është që të krijohet baza e përgjithshme kontraktuale që mundëson që Kosova të përfitojë nga fondet e Bashkimit Evropian të ofruara në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje.

Kurse, qëllimi i marrëveshjes për kredinë është që të rregullojë kushtet e ndërlidhura specifiku për marrjen e pjesës së fondeve të Bashkimit Evropian, që ofrohen si kredi dhe mënyrën e menaxhimit të tyre.

Dua të rikujtoj se si Qeveri, kur ishim në mandat të plotë, i kemi dhënë rëndësi dhe prioritet këtij Instrumenti, ashtu që të respektohen të gjitha afatet e vendosura nga ana e Komisionit Evropian. Ne kemi qenë ndër shtetet e para, në mos të parët, që kemi finalizuar agjendën e reformave dhe këtë e kemi arritur brenda afatit fillestar të vendosur nga Komisioni Evropian, gjersa formalisht e kemi miratuar qysh në tetor të vitit 2024.

Megjithëkëtë, pjesërisht nga vonesat në finalizimin e agjendës së reformave nga disa prej shteteve të tjera përfituese, e pjesërisht për shkak të punës paralele që është zhvilluar nga vetë Komisioni Evropian për rregulloren e nevojshme për themelimin e këtij Instrumenti të ri dhe formatet e marrëveshjeve respektive, nuk ka qenë e mundur procedimi i tyre nga legjislatura e kaluar e Kuvendit.

Formati standard përfundimtar i dakorduar i marrëveshjes për Instrumentin për Reforma për Kosovën është dërguar te ne më 15 nëntor në mënyrë elektronike. Dhe, ne e kemi kryer nënshkrimin sapo ka ardhur në Kosovë fizikisht dhe është pranuar në Qeveri, përkatësisht më 27 nëntor, ku po të njëjtën ditë është miratuar Projektligji për ratifikimin e saj nga Qeveria, pra në kohë rekorde prej anës sonë si ekzekutiv.

Kurse, për Marrëveshjen për kredi, ne e kemi miratuar nismën më 13 nëntor 2024, mirëpo draftin final të marrëveshjes e kemi pranuar pas shpërndarjes së Kuvendit, në janar të vitit 2025. Si rezultat, kjo ka pamundësuar që marrëveshjet të hyjnë në fuqi dhe ne si shtet të mos mund të përfitojmë nga parafinancimi në vlerë prej 7 për qind, si dhe shumat e alokuara për reformat e implementuara.

Andaj, meqenëse afatet janë fikse dhe po ecin, sepse koha po kalon, ju ftoj sot që të votojmë miratimin e këtyre projektligjeve, të fillojmë të përfitojmë nga ky Instrument. Koha nuk është burim i ripërtrishëm, kalon në pakthim.

Çdo vonesë e mëtutjeshme e komplikon dhe e rrezikon si përfitimin, ashtu edhe zbatimin e fondeve.

Tjetra, sa u përket marrëveshjeve me Bankën Botërore. Me Bankën Botërore i kemi tri marrëveshje; njëra është në vlerë prej 90 milionë eurosh dhe vjen si mbështetje buxhetore, kurse dy të tjerat janë nga 18.6 milionë euro secila dhe janë për financim të projekteve aq shumë të nevojshme në arsim e në shëndetësi.

Marrëveshja prej 90 milionë eurosh vjen në kuadër të Programit të Reformave që e kemi zbatuar në bashkëpunim me Bankën Botërore, dhe si shpërblim për arritjet, norma e interesit do të jetë zero për qind për dymbëdhjetë vjet. Pra, kamatë zero për qind. Një kredi me këso kamatë zero për qind do ta kishte lakmi secili shtet në çdo kohë dhe as që do të diskutohet a duhet miratuar apo jo. Por, ja që te ne ka më shumë se një vit që ajo e pret ratifikimin.

Nëse ka diçka për të cilat do të hyjmë në histori, është pikërisht kjo, që një kredi me zero për qind kamatë pret ratifikimin një vit, ndërkohë që nuk do të duhej të kishte diskutim fare. Sepse, një kredi të tillë, po e ritheksoj, do ta kishte lakmi secili shtet i botës në çdo kohë. Dhe, nëse nuk ratifikohet në këtë seancë, e vendi shkon në zgjedhje, atëherë këto mjete, pra 90 milionë euro, për të cilat ne si Qeveri kemi punuar e jemi angazhuar shumë, do të humbin, sepse ka shumë shtete të tjera që e presin me krahapur një financim të tillë.

Ngjashëm, edhe dy marrëveshjet për financim të projekteve. Në arsim parashihet investimi në çerdhe të reja, kurse në shëndetësi parashihet ndërtimi i Sistemit Informativ Shëndetësor, që është parakusht për funksionalizimin e sigurimit shëndetësor.

Nëse këto dy marrëveshje nuk miratohet sot nga Kuvendi, atëherë edhe mjetet për këto dy projekte do të humben dhe do të shkaktohen vonesa të pakthyeshme në ndërtim të çerdheve për fëmijë, si dhe në zbatim të sigurimeve shëndetësore.

Më tej, ju e dini që në mbledhjen e 273-të Qeverisë së Republikës së Kosovës e kemi miratuar buxhetin për vitin 2026.

Së pari kam kënaqësinë të them që është një buxhet, më i madhi ndonjëherë në vlerë prej rreth 4 miliardë euro, ku $\frac{1}{4}$ apo rreth 1 miliard euro janë buxhetuar për investime kapitale. Një risi në këtë buxhet do të jetë edhe dhënia e pagës së 13-të për të gjithë punonjësit e sektorit publik.

Pra, kushdo që punon 12 muaj në sektorin publik, me qeverinë që ka sjellë buxhetin për vitin 2026, në fund të vitit do të mund të përfitojë edhe pagën e 13-të.

Gjithashtu, është i përfshirë edhe zbatimi i rritjes së pagës bazë me 0,5% për çdo vit përvojë pune, për dallim prej asaj që kemi pasur më herët, ku në 15 vjetët e para të përvojës së punës zbatohet rritja përgjysmë më e vogël, apo vetëm 0,25% për çdo vit përvojë pune. Kjo përket në rritje shtesë për pagën e secilit që punon në sektorin publik, varësisht nga vitet e përvojës së punës.

Buxheti që kemi sjellë në Kuvend për vitin 2026 përfshin edhe rritjen e pensioneve, shtesave për fëmijë, shtesave për lehonat, pagesat për të rinjtë dhe gratë që angazhohen nga Super-Puna, kompletimi i reformës së asistencës sociale, e shumë e shumë të tjera mbështetje për familjet anëmbanë Kosovës, pa dallim komune apo komunitetit.

Me këtë buxhet rritet mbështetja për barna esenciale, por rritet gjithashtu edhe mbështetja për kulturën dhe për sportin. Rritet mbështetja për ndërmarrësit për sektorin privat dhe për bujqit, por rritet edhe buxheti për investime në infrastrukturën publike. Mirëpo, para së gjithash, me këtë buxhet sigurohet qëndrueshmëria dhe vijueshmëria e shtetit tonë dhe zhvillimit të tij e progresi shoqëror në vendin tonë.

Radiotelevizioni i Kosovës gjithashtu është në rend dite sot. RTK-ja është institucion publik i themeluar nga Kuvendi dhe Kuvendi është përgjegjës për financimin e Radiotelevizionit të Kosovës. Buxheti për Radiotelevizionin e Kosovës madje as nuk varet nga Qeveria. Interaksioni i vetëm i RTK-së është me trupat e Kuvendit, konkretisht me Komisionin për Buxhet, i cili duhet të miratojë alokimin e fondeve për RTK-më.

Me atë vendim, Thesari me automatizëm bën ekzekutimin e transferit. Pra, te rasti i RTK-së kemi një lidhje direkt midis Komisionit për Buxhet të Kuvendit të Republikës me Thesarin e shtetit që ndodhet në kuadër të Ministrisë së Financave. Pra, as nuk ka propozim, e as miratim nga Qeveria. Krejt çfarë duhet mund të bëhet përbrenda Kuvendit, duke themeluar Komisionin për Buxhet.

Prandaj, nëse për Ligjin e buxhetit opozita paska vërejtje e brenga në raport me Qeverinë tonë në detyrë, kjo nuk ekziston fare në rastin e RTK-së. Financimi për RTK-në nuk ka të bëjë me Qeverinë; Komisioni për Buxhet, Thesari i shtetit.

Në gusht të këtij viti, në mungesë të një Kuvendi të konstituuar, ne si Qeveri në detyrë e morëm vendimin që të ofrojmë një zgjidhje imediate, por të përkohshme. Një overdradft, nëse mund të quhet ashtu, i cili do të mbulonte nevojat deri në konstituim të Kuvendit, meqenëse nuk e kishim ende Kuvendin të konstituuar, sepse nuk ishte zgjedhur Kryesia e Kuvendit. Por, tash Kuvendi është i konstituuar. Nuk ka asnjë arsye që të refuzohet miratimi i buxhetit të RTK-së nga Kuvendi.

Ndërsa, Qeveria, në anën tjetër, e ka të pamundur të ofrojë overdraft mbi overdraftin kur vetë themeluesi i Radiotelevizionit të Kosovës, që është Kuvendi i Republikës, refuzon të alokojë buxhetin.

Të nderuar deputetë,

Çdo Kuvend ka legjitimitet që të marrë vendime në dobi të shtetit e të shoqërisë. Legaliteti vlen për të mbështetur legjitimitetin që Kuvendit i buron nga populli. E drejta duhet edhe të ketë efekt në shoqëri. Nuk mjafton të jetë letër procedurash. Demokracia njëmend është edhe procedurë, por procedurë për t'i bërë mirë shtetit dhe shoqërisë, jo për ta bllokuar veten, apo për ta pamundësuar dhënien e së mirës.

I kemi marrëveshjet ndërkombëtare, që i ka proceduar presidentja e Republikës. Ato i duan 80 vota. Kjo nuk ka të bëjë me asnjërin prej nesh, veç e veç. Nuk ka rrugë tjetër, veçse të gjithë bashkë të votojmë. Buxhetet e komunave 2025 duhet gjithashtu të votohen që të bëhen pagesat dhe të fshihen borxhet.

Tri komuna të Kosovës: Prishtina, Gjlani dhe Zubin Potoku, të nderur deputetë dhe ju të tjerë të pranishëm, po operojnë çdo muaj me 1/12 e buxhetit të vitit 2024. Merreni me mend, jemi në prag të vitit 2026, e këto tri komuna operojnë me 1/12 e buxhetit të vitit 2024. Pse të vazhdojë ky kufizim dhe ky pengim i tyre për projektet e tyre për qytetarët e tyre e tanë.

Buxheti i vitit 2026, që e ka propozuar Qeveria e Republikës së Kosovës, që është miratuar në mbledhjen tonë, është tejet i rëndësishëm, sepse duhet që janari t'i gjejë të gjithë me paga e me rritje të merituar, të cilat burojnë nga rritja ekonomike.

Të nderuar deputetë,

Në Kosovë nuk ka krizë ekonomike. Rritja ekonomike në çerekun e dytë sivjet ka qenë 4,58% të bruto-produktit vendor. Në këto katër vjet sa isha kryeministër, e tash edhe sa jam kryeministër në detyrë, asnjëherë rritja ekonomike nuk ka qenë nën 4%. Rritja mesatare ekonomike është 6%.

Prandaj, edhe nuk ka protesta të qytetarëve, por ka vetëm ankesa të opozitarëve. Në Kosovë nuk ka krizë ekonomike. Po, rrezikojmë të kemi krizë sociale nga kriza buxhetore e financiare për shkak të keqpërdorimeve që procedurave. Le të mos keqpërdorim procedurat. Le të jemi në nivel të përgjegjësisë që kemi si përfaqësues të popullit, por edhe si zyrtar të shtetit. Si dikush që personifikon dhe sendërton imazhin e shtetit të pavarur si Republikë demokratike.

Qëndrimet e subjekteve, të cilat nuk janë të pranishme, për besë nuk kanë alibi. Nëse ne sipas tyre qenkemi vonuar, pse nuk janë këtu për të na e lënë neve fajin, e popullit buxhetin. Nëse qenkemi vonuar, pse nuk janë këtu që të na e lënë neve fajin, e popullit buxhetin. Këtu është vendi për të folur e për të votuar.

Mbi 200 milionë euro humbin pakthyesëm. 88 milionë euro nga Plani i Rritjes së Bashkimit Evropian dhe 120 milionë euro nga këto tri marrëveshjet me Bankën Botërore. E për ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare, ju e dini shumë mirë, që nuk mjaftojmë ne. Edhe po ta kishim Qeverinë, nevojiten 80 vota. Por, interesi publik dhe e mira shoqërore e kërkon që të jemi aty bashkë.

Është një çështje tjetër; po të kishte parti opozitare që do të thoshin: nuk duam të marrim kredi nga bashkësia ndërkombëtare, që është qëndrim politik. Pra, nuk duam marrim kredi. Edhe nëse është 0%, nuk duam të marrim kredi. Nuk na nevojiten grantet e Bashkimit Evropian. Nëse do të kishte parti opozitare që do të thoshin kështu qëndrimesh politike, unë i kuptoj.

Se edhe për marrëveshjet ndërkombëtare, pozitë dhe opozitë mund të dallojnë, mirëpo ata nuk kanë asnjë vërejtje për këto marrëveshje ndërkombëtare. Cili është kuptimi të bojkotosh votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërkohë që pajtohesh për to?!

Unë u bëj thirrje edhe një herë të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës, pa dallim partie, që sot të jemi këtu në Kuvend, ku na ka sjellë populli i Kosovës, dhe t'i votojmë tri marrëveshjet me Bankën Botërore. Marrëveshjen për Planin e Rritjes së Bashkimit Evropian për vendin tonë, afër 900 milionë euro gjithsej. Buxhetin për tri komunat: Prishtinë, Gjiilan, Zubin Potok. Buxhetin për vitin 2026. Dhe, në këtë mënyrë të ecim bashkë përpara.

Të gjitha ballafaqimet e ideve që kemi, e zgjedhjeve që japim, le t'i ruajmë për diskutime në fushatën zgjedhore, por gjithashtu edhe për diskutime parlamentare këtu, pse jo? Mirëpo, kjo seancë nuk është thjesht një zgjedhje, është një domosdoshmëri, edhe më shumë se nevojë, nëse duam të jemi ashtu siç na kanë zgjedhur. Pra, përfaqësues të popullit të Kosovës, si burim sovraniteti i shtetit tonë të dashur e të përbashkët. Ju faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar zonja Gërvalla.

DONIKA GËRVALLA-SCHWARZ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë të pranishëm,

Ju përfaqësues të mediave,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dhe, të nderuar, gjithashtu, deputetë të atyre partive, të cilat kanë zgjedhur sot të mos jenë të pranishëm në këtë sallë,

Unë nuk do të merrem as me interpretime ligjore, sepse është e qartë situata ligjore rreth kësaj seance. As nuk do të merrem me interpretime se sa e dëmshme apo jo është çdo vonesë që shkaktohet, mirëpo duke pasur pritje goxha të ulëta në raport me PDK-në, AAK-në, dhe duke mos pasur asnjë lloj pritjeje në raport me Listën serbe, më lejoni që nga kjo foltore t'u drejtohem me një apel publik deputetëve të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Të nderuar deputetë të LDK-së,

Duke e njohur pulsën, duke e njohur përkushtimin dhe duke e njohur vullnetin e votuesve të partisë suaj, më mirë ndoshta se ata që kanë përgjegjësi të larta në partitë tuaja, ju ftoj publikisht që si parti e ardhur nga një traditë institucionaliste, të mos bëheni bashkë me ata të cilët nuk i respektojnë institucionet e shtetit, të cilët bllokojnë procese të rëndësishme, të cilët e bllokojnë buxhetin, i bllokojnë pagat dhe e bllokojnë të ardhmen e këtij vendi.

Ju bëj apel publik sot të gjithë juve që e keni mundësinë, meqenëse kjo seancë nuk do të mbyllet tani me sa e kuptova kryetarin e Kuvendit, që të vini në një orë më të vonshme dhe të votoni marrëveshjet ndërkombëtare në atë sensin, i cili në parimet në të cilat është krijuar, është ndërtuar, është zhvilluar partia juaj. Të mos bëheni kontribuues të ndërtimit të shtetit, sepse kjo as nuk ju bën nder juve personalisht si deputetë që keni marrë përgjegjësi, por as nuk do të ketë përkrahje të votuesit juaj, i cili ju fort mirë e dini se cilat pritje i ka ndaj jush.

Prandaj, ky apel publik ju drejtohet juve të nderuar deputetë të LDK-së, me ftesën publike që në seancë të vini dhe të votoni zhblokimin e proceseve kaq të rëndësishme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Gërvalla! Fjalën e ka kërkuar zoti Hekuran Murati.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E kërkoja fjalën, gjithashtu, t'i shtohen pra lutjes së zonjës Donika Gërvalla-Schwarz në raport me apelin për deputetët e Kuvendit të Republikës dhe rëndësinë, pra që sot, këto pika të rendit të ditës të kësaj seance. Pra, buxheti për RTK-në. Buxheti për tri komunat për vitin aktual për vitin 2025, për Prishtinë, Gjiilan dhe Zubin Potok, marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe Buxheti për vitin e ardhshëm 2026 të miratohen, sepse këto janë buxhete dhe financime për qytetarët e Republikës së Kosovës, për të gjithë.

Pra, mund të kenë etiketën e Qeverisë, apo të ndonjë komune specifike, por megjithatë përfituesit fundorë janë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Prandaj, më lejoni që shkurtimisht vetëm të kaloj nëpër disa prej dëmeve, apo pasojave që do të shkaktohen nëse sot nuk miratohen këto pika të rendit të ditës.

Sa i përket buxhetit për RTK-në, siç edhe është sqaruar tashmë, nevojitet funksionalizimi i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere. Nuk ka asnjë pengesë, përpos asaj politike. Pra, s'ka asnjë pengesë ligjore apo kushtetuese, apo me Rregulloren e Kuvendit, që Komisioni për Buxhet të funksionalizohet dhe të miratohet alokimi i buxhetit të RTK-së për deri në fund të vitit.

Nëse kjo nuk ndodh sot, problemi do të sterkeqësohet edhe më tepër, sepse dhe nëse shkojmë pa buxhet në vitin e ardhshëm, pra përderisa për pjesën tjetër të administratës publike vlen Ligji për financat publike, që mjafton ose mund të ndahet 1/12 për dy muajt e parë, pra për janar dhe për

shkurt, te RTK-ja as kjo nuk mund të bëhet. As në janar, as në shkurt nuk mund të ndahet 1/12 për RTK-në, sepse nuk do ta ketë Komisionin për Buxhet funksional.

Dhe, në mungesë të një Komisioni për Buxhet funksional dhe në mungesë të miratimit të buxhetit të RTK-së për atë komision, rrezikohet që RTK-ja të mos ketë financim deri në fillim të marsit së paku. Kjo do të ishte katastrofale për institucionin e RTK-së, për transmetuesin publik.

Pra, nëse tash aktualisht ata janë pa paga, me mosmiratimin apo mosfunksionalizimin e Komisionit për Buxhet dhe mosmiratimin e buxhetit për RTK, rrezikohet që RTK-ja të mbetet pa buxhet deri në muajin mars, kur edhe në rastin më të mirë do të mund të kishte buxhet të miratuar dhe Komisionin për Buxhet funksional. Pra, është pasojë e jashtëzakonshme dhe shkatërruese, me efekt shkatërrues, nëse sot nuk votohet Komisioni për Buxhet dhe nuk miratohet buxheti i RTK-së.

Pika tjetër është buxheti për tri komunat për vitin aktual. Kjo s'ka të bëjë me vitin 2026, jemi duke folur për Prishtinë, Gjiilan dhe Zubin Potok për buxhetin e vitit 2025. Janë me miliona euro fatura dhe detyrime të grumbulluara të këtyre tri komunave që kanë lenë, qoftë operatorë ekonomikë, qoftë ndërmarrjet publike pa paga, dhe të cilat, nëse nuk miratohet buxheti i vitit 2025, pra për sivjet, dhe nuk lejohet që këto mjete të shpenzohen, atëherë këto obligime do të barten në vitin e ardhshëm fiskal.

Dhe, edhe nëse miratohet pastaj buxheti i vitit të ardhshëm, këto obligime do të merren me përmbarues dhe do të shkaktojmë një cikël tjetër problemesh te këto komuna.

Prandaj, është e domosdoshme që buxheti i këtyre tri komunave të miratohet sot, për vitin 2025 është fjala. Edhe një herë, s'ka të bëjë kjo asgjë me Ligjin e buxhetit për vitin 2026.

Nuk e kuptoj, sepse nuk ka asnjë pengesë. Nuk ka asnjë arsye për të pasur brenga apo shqetësime. Nëse e paskan shqetësimin për buxhetin e vitit 2026, e që edhe për atë nuk qëndron, por që le ta marrim që paska shqetësime opozita për buxhetin e vitit 2026, buxheti i këtyre tri komunave nuk është buxhet i Qeverisë, është buxhet që është miratuar nga tri kuvendet komunale; nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, i Gjilanit dhe i Zubin Potokut. Fatkeqësia është që janë miratuar me vonesë pas afateve ligjore. Dhe, tash duhet miratim i veçantë në Kuvend, në mënyrë që këto buxhete të hyjnë në fuqi.

Pra, edhe një herë, lus deputetët e opozitës të PDK-së, LDK-së, AAK-së që të reflektojnë dhe të kthehen në seancë dhe të miratojnë buxhetet për këto tri komuna.

Çështja tjetër janë edhe marrëveshjet ndërkombëtare. Nëse nuk miratohen marrëveshjet ndërkombëtare sot, siç u theksua edhe nga parafolësit, rrezikojmë që të humbim mbi 200 milionë euro pakthyesëm. Janë 88 milionë euro nga Plani i Rritjes së BE-së, të cilat humben. Pra, 10% e

shumës së tërësishme. Dhe, janë edhe marrëveshjet ndërkombëtare me Bankën Botërore, të cilat po ashtu nëse nuk i miratojmë me kohë dhe deri në fund të vitit, edhe ato mjete do të humbin, sepse ka shumë shtete të tjera që presin dhe me kënaqësi i pranojnë mjetet, të cilat Kosova fatkeqësisht, pra Kuvendi nuk po i miraton. Me fjalë të tjera, i bie se po i refuzon.

Prandaj, është tepër e rëndësishme që edhe këto marrëveshje të miratohen sot, në mënyrë që të shpëtohen dhe të mos humbin 200 milionë euro të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Pika tjetër, apo e fundit, është edhe buxheti për vitin 2026. U sqarua tashmë po besoj, por më lejoni ta ripërsëris edhe një herë që edhe me Ligjin për Qeverinë, neni 31 i ligjit dhe konkretisht paragrafi 2 në kombinim me paragrafin 5 të ligjit e mundëson që edhe Qeveria në detyrë të dorëzojë para Kuvendit Ligjin për ndarje buxhetore për vitin ardhshëm fiskal. Por, për më tepër, kjo çështje është e rregulluar edhe me Kushtetutë. Kushtetuta në mënyrë specifike e thekson që Ligji i buxhetit është i vetmi ligj, të cilin vetëm Qeveria ka të drejtë ta dorëzojë në Kuvend, asnjë instancë tjetër.

Përderisa ligjet e tjera të rregullta mund t'i dorëzojë edhe presidentja, mund nismë ligjore nga deputetët, është vetëm një ligj për të cilin Kushtetuta të drejtën ekskluzive ia ka rezervuar Qeverisë, pavarësisht statusit të qeverisë, a është qeveri fuqiptotë, qeveri në detyrë, apo qeveri në dorëheqje.

Prandaj, nuk ka asnjë dilemë sa i përket edhe buxhetit për vitin 2026. E vërtetë që Ligji për financat publike e parasheh zgjatjen për dy muajt e parë të vitit në rast se ka zgjedhje deri në fund të vitit fiskal. Megjithatë, kjo zgjatje megjithëse do të ishte një zgjidhje emergjente nuk na siguron, pra fillimisht nuk mund të paguhen as pagat, e as pensionet, e as të gjitha përfitimet e tjera siç janë duke u paguar aktualisht.

Sepse, siç e dini, pagat e sektorit publik kanë pasur rritje në korrik të këtij viti dhe nëse aplikohet paga e janarit apo çeku i pagave të janarit, atëherë duhet të kthehemi në pagën e janarit 2025. Pra, që nënkupton pagat e sektorit publik do të ishin 55 euro më të ulëta. Ngjashëm vlen edhe për shtesat dhe për pensionet. Pra, megjithëse mund të jetë një zgjidhje emergjente, megjithatë është e paplotë dhe do të shkaktonte pasoja të gjithë ata qytetarë që përfitojnë nga ky buxhet. Kjo s'ka të bëjë me Qeverinë, ka të bëjë me qindra e mijëra qytetarë të cilët varen nga buxheti i Republikës së Kosovës, dhe është e domosdoshme që të miratohet ky buxhet.

Këto janë pasojat për RTK-në. Për tri komunat për buxhetin e sivjetshëm. Për marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe për buxhetin e vitit të ardhshëm, në rast sot në këtë seancë nuk miratohen këto pika të rendit të ditës.

Unë dyshoj që deputetët e opozitës me vetëdije do të donin t'i shkaktonin këto pasoja për qytetarët e Republikës së Kosovës. Unë nuk do të besoj që deputetët duan t'i lënë punëtorët e RTK-së pa financim e pa paga deri në mars të vitit të ardhshëm. Unë nuk besoj që deputetët e këtij Kuvendi, pra të opozitës, dëshirojnë t'i humbin pakthyeshem 200 milionë euro të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Unë refuzoj të besoj që deputetët e këtij Kuvendi, pra të opozitës, nuk duan që tri komunat të cilat e kanë miratuar buxhetin e tyre në kuvende komunale me vonesë nuk duhet ta kenë buxhetin. Unë dyshoj të besoj dhe nuk dua të besoj që këta deputetë të partive opozitare kanë dëshirë që të shkaktojnë dëme të këto komuna. Dua ta besoj të kundërtën.

Dhe, nuk dua të besoj që partitë opozitare, pra po duan që me mosmiratim të buxhetit të shkaktojnë kriza, apo të fabrikojnë kriza të tjera, qoftë buxhetore apo financiare dhe për pasojë edhe kriza sociale.

Prandaj, duke mos dashur të besoj se e kanë këtë qëllim të keq, duke dashur të besoj që kanë qëllime të mira dhe i qëndrojnë besnik betimit të deputetit që e kanë dhënë, i ftoj edhe një herë, po e shfrytëzoj rastin që t'ju bëj apel të gjithë deputetëve të opozitës, sepse e di që shumica e tyre tashmë janë në Kuvend, janë në zyrat e grupeve parlamentare përkatëse, krejt çfarë duhet është të vijin në këtë sallë dhe të dakordohemi që këto pika të rendit të ditës të miratohen, në mënyrë që të mos rrezikojmë të ardhurat e qindra-mijëra qytetarëve, të mos rrezikojmë qindra-miliona euro të na humbin, dhe pastaj mund të vazhdojmë tutje dhe me seancën e radhës.

Nëse votohet Qeveria mirë, nëse nuk votohet, e përmendi këtu edhe deputeti Gruda, tha: do të bëjmë fushatë, mund të bëjmë edhe fushatë, po le ta lëmë fushatën përgjatë kohës që është e paraparë me Ligjin për zgjedhjet.

Këtu le të përkujdesemi t'i qëndrojmë besnik betimit të dhënë, dhe këtu jemi në shërbim të të gjithë qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Me radhë kemi deputetin Mefail Bajqinovci.

MEFAIL BAJQINOVCI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Media,

Qytetarë të Republikës,

Nuk e pata ndërmend ta marr fjalën, por pasi që doli deputeti i Partisë Demokratike dhe tha se është seancë antikushetuese, unë e kam një problem se a t'i besoj Arsim Bajramit, a t'i besoj Përparim Grudës, bashkëthemeluesit të Partisë Demokratike, hartuesit të Kushtetutës, profesorit të Fakultetit Juridik.

I kam nja 30 sekonda se çka thotë në emision zoti Bajrami, se a është seanca antikushtetuese për buxhetin në rast se nuk kemi Qeveri. Desha ta lëshoj me video, sepse do të thonë që ta citoj nuk bën, se nuk është e vërtetë.

Ja se çka thotë profesor Bajrami për këtë seancë.

(Deputeti e lëshon një video-incizim në foltoren e Kuvendit, ku dëgjohet duke folur profesori i Fakultetit Juridik, Arsim Bajrami, njëri nga hartuesit e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.)

Çka po dua të them, është që i kemi dy deklarata. Një profesor, një hartues i Kushtetutës, i cili thotë: nuk është asgjë antikushtetuese. Dhe, e kisha lutur opozitën, gjë që e ceku edhe më herët zoti Murati, që nga zyrat e Kuvendit të Republikës së Kosovës të vijnë e ta votojnë buxhetin dhe të mos e lënë Prishtinën në kolaps, Gjilanin, Radiotelevizionin e Kosovës dhe institucionet e tjera, Zubin Potokun dhe të gjitha të tjerët që mund të mbesin pa paga. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk kemi deputetë të tjerë që kanë kërkuar fjalën. Sa për informacion, i ndërpres diskutimet këtu. Seanca mbetet e hapur. Në rast se kemi ndryshim të qëndrimeve, edhe unë ju bëj thirrje të gjitha subjekteve politike, deputetëve të Kuvendit që t'u bashkëngjiten të gjithë deputetëve të tjerë, që të mblidhemi dhe t'i tejkalojmë këto ligje që janë me rëndësi jetike për të gjithë qytetarët e Republikës. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*